



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësi Org. Org. Jedinica Org. Unit	02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No	05-6/106
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	-20-
Data: Datum: Date:	02/10/2023
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm – Ured Generalnog Sekretara –Office of the General Secretary

Datë:29.09.2023

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), me qëllim të zbatimit të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr 04/2023 Për Trajtimin Mjekësor Psikologjik të Fëmijës Viktimë të Abuzimit, për të ndihmuar në Rehabilitim dhe për t'u integruar në Shoqëri, në zbatim të shkresës nr. ref.155/2023 dt. 17 Korrik 2023, nxjerr këtë:

Qarkore Informative Nr. 07/2023

Për: Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës përfshirë Spitalet e përgjithëshme
Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare,
Drejtoreve për shëndetësi dhe mirëqenie sociale në Komuna
Drejtoreve të Arsimit në Komunë
Policisë së Kosovës

Qëllimi : Zbatimi i detyrave dhe obligimeve sipas Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr 04/2023 Për Trajtimin Mjekësor Psikologjik të Fëmijës Viktimë të Abuzimit, për të ndihmuar në Rehabilitim dhe për t'u integruar në Shoqëri.

Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 04/2023 Për Trajtimin Mjekësor Psikologjik të Fëmijës Viktimë të Abuzimit, për të ndihmuar në Rehabilitim dhe për t'u integruar në Shoqëri është miratuar në Mbledhjen e 142-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. 03/142 të datës 10.05.2023 dhe i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 05.06.2023.

Me shkresën nr. ref.155/2023 dt. 17 Korrik 2023 Letër zotimi për zbatimin e Programit Kombëtar për Integrim Evropian 2023-2027, Ministria e Shëndetësisë zotohet të zbatojë tri (3) reforma gjatë vitit 2023 ndër to: Miratimin dhe zbatimin e Udhëzimit Administrativ 04/2023 Për Trajtimin Mjekësor Psikologjik të Fëmijës Viktimë të Abuzimit, për të ndihmuar në Rehabilitim dhe për t'u integruar në Shoqëri.

Obligimet e institucioneve:

1. Obligohen institucionet e lartëpërmendura për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ nr. 04/2023.
2. Shtojcë e kësaj Qarkoreje është Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 04/2023 Për Trajtimin Mjekësor Psikologjik të Fëmijës Viktimë të Abuzimit, për të ndihmuar në Rehabilitim dhe për tu integruar në Shoqëri dhe shkresa nr. ref.155/2023 dt. 17 Korrik 2023.



Dr. Naim Bardiqi

Sekretar i Përgjithshëm

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- SHSKUK/Spitalet e përgjithëshme;
- Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare;
- Drejtorive për shëndetësi dhe mirëqenie sociale në Komuna;
- Drejtorive të Arsimit në Komuna;
- Policisë së Kosovës;
- Inspektoratit Shendetesor;
- Departamentit ligjor;
- Arkivit të MSh-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/142
Datë: 10.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Trajtimin Mjekësor dhe Psikologjik, të Fëmijës Viktimë e Abuzimit, për t'i Ndihmuar në Rehabilitim dhe për t'u ri Integruar në Shoqëri.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) - NR. 04/2023 PËR TRAJTIMIN
MJEKËSOR DHE PSIKOLOGJIK, TË FËMIJËS VIKTIMË E ABUZIMIT,
PËR T'I NDIHMUAR NË REHABILITIM DHE PËR T'U RI INTEGRUAR
NË SHOQËRI¹**

¹ Udhëzimi Administrativ (QRK) - Nr. 04/2023 për Trajtimin Mjekësor dhe Psikologjik, të Fëmijës Viktimë e Abuzimit, për t'i Ndhmuar në Rehabilitim dhe për t'u ri Integruar në Shoqëri, është miratuar në Mbledhjen e 142-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 03/142, të datës 10.05.2023.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të Nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me Nenin 57.10 të Ligjit Nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës (GZ, Nr. 14, 17 korrik 2019, dhe Nenin 19 (6.2) të Rregullores së Punës së Qeverisë nr. 09/2011 (GZ, nr. 15, 12.09.2011),

Miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK)-NR. 04/2023 PËR TRAJTIMIN MJEKËSOR DHE PSIKOLOGJIK, TË FËMIJËS VIKTIMË E ABUZIMIT, PËR T’I NDIHMUAR NË REHABILITIM DHE PËR T’U RI INTEGRUAR NË SHOQËRI

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet trajtimi mjekësor dhe psikologjik i fëmijës viktimë e abuzimit, në mënyrë që të rifitojë shëndetin fizik dhe mendor, të rehabilitohet nga trauma fizike dhe mendore që mund të ketë përjetuar si dhe për t’u ri integruar në shoqëri, në mënyrë, që ai të luajë një rol konstruktiv në shoqëri si dhe për të shmangur ri viktimizimin dhe përjashtimin social.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Ky Udhëzim Administrativ zbatohet:

1.1 Nga institucionet dhe nga personat fizik dhe juridik, të cilët punojnë me fëmijën dhe për fëmijën, e që kanë përgjegjësi për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijës viktimë e abuzimit, në përputhje me obligimet e tyre të dala nga legjislacioni përkatës në fuqi dhe me këtë udhëzim administrativ

1.2 Për fëmijën me shtetësi kosovare, pa shtetësi, të pa regjistruar, azilkërkues, refugjat ose me shtetësi të huaj, brenda territorit të Republikës së Kosovës.

2. Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ nuk mund të merren si kufizim, apo pakësim i të drejtave ekzistuese të fëmijës të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për mbrojtjen e fëmijës, Konventën për të Drejtat e Fëmijës ose me instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë fushë, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.

3. Dispozitat e Udhëzimit Administrativ (QRK) – Nr. 02/2021 për zbatimin e drejtësisë mike ndaj fëmijës në procedurën penale, civile dhe administrative, me të cilat përcaktohen rregullat e drejtësisë mike ndaj fëmijës, duhet të zbatohet edhe në procedurën e trajtimit mjekësor dhe psikologjik të fëmijës viktimë e abuzimit, dhe në zbatimin e masave për rehabilitim dhe për ri integrim të tij.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura për qëllim të këtij udhëzimi administrativ kanë këtë kuptim:

- 1.1. **Abuzimi i fëmijës** - nënkupton çdo veprim apo mosveprim, i qëllimshëm apo me paramendim, i kryer nga prindi, kujdestari, personi i besueshëm apo ndonjë person tjetër në pozitën e të besuarit, ose autoritetit që shkakton ose ka gjasa t'i shkaktojë dëm fizik, psikologjik, emocional apo social fëmijës. Abuzim i fëmijës, në kuptim të këtij udhëzimi administrativ përfshinë por nuk kufizohet në të gjitha format e dhunës ndaj fëmijës, neglizhimin e fëmijës, keqtrajtimin, prostitucionin me fëmijë, pornografinë me fëmijë, rrëmbimin e fëmijës, trafikimin e fëmijës, shfrytëzimin, abuzimin seksual të fëmijës;
- 1.2. **Fëmijë** – nënkupton çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç;
- 1.3. **Fëmijë viktimë e abuzimit** – nënkupton fëmijën në nevojë për mbrojtje, i cili është i abuzuar;
- 1.4. **Institucion** – nënkupton të gjitha institucionet, autoritetet, organet publike, të nivelit qendror dhe lokal, personat privat si bartës të autoriteteve publike si dhe personat e tjerë juridikë e privat në Republikën e Kosovës, që kanë përgjegjësinë për mbrojtjen e fëmijës viktimë e abuzimit;
- 1.5. **Konventa për të drejtat e fëmijës/Konventa** - Konventa për të drejtat e fëmijës e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989;
- 1.6. **Kujdesi shëndetësor** - masat dhe veprimet që ndërmerren nga institucionet, dhe profesionistët shëndetësor, që kanë për qëllim përmirësimin e shëndetit të fëmijës, për t'i ndihmuar në rehabilitim dhe për t'u ri integruar në shoqëri;
- 1.7. **Ligji për mbrojtjen e fëmijës/Ligji** - Ligji Nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës (Gazeta Zyrtare nr. 14, 17 korrik 2019);
- 1.8. **Ligji për shërbime sociale dhe familjare** - Ligji nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare (Gazeta Zyrtare nr. 12, 01 maj 2007) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-081 (Gazeta Zyrtare, nr. 5, 05 prill 2012);
- 1.9. **Ligji për shëndetësi** - Ligji nr. 04/L-125 për shëndetësi (Gazeta Zyrtare, nr. 13, 07 maj 2013);

- 1.10. **Mbrojtja e fëmijës** - nënkupton parandalimin dhe përgjigjen ndaj abuzimit të fëmijës brenda dhe jashtë shtëpisë, që përfshin trajtimin mjekësor dhe psikologjik, të fëmijës viktimë e abuzimit, për t'i ndihmuar që të rifitojë shëndetin fizik dhe mendor, të rehabilitohet nga trauma fizike dhe mendore që mund të ketë përjetuar si dhe për t'u ri integruar në shoqëri;
- 1.11. **Menaxheri i rastit** - nënkupton zyrtarin përgjegjës të caktuar nga Organi i Kujdestarisë, për menaxhimin e rastit të fëmijës viktimë e abuzimit, i cili në bashkëpunim me akterët relevantë vlerëson nevojat e fëmijës dhe harton planin e përkujdesjes.
- 1.12. **Ministria** - Ministria përkatëse për shëndetësi;
- 1.13. **Në të gjitha fazat** - përfshin të gjitha procedurat në të cilat fëmija viktimë e abuzimit është në kontakt me institucionet përkatëse apo me profesionistët për mbrojtjen e fëmijës;
- 1.14. **Qendra për Punë Sociale/QPS** - nënkupton institucionin publik profesional, të nivelit komunal, kompetent edhe për mbrojtjen e fëmijës viktimë e abuzimit;
- 1.15. **Raste emergjente** - konsiderohen rastet kur fëmija viktimë e abuzimit, i cili nëse lihet në rrethanat aktuale, pa asnjë ndërhyrje mbrojtëse, mund të vdesë, të dëmtohet ose plagoset rëndë, apo të jetë pre e keqtrajtimeve tjera.

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin për mbrojtjen e fëmijës dhe Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare.

KAPITULLI II - TË DREJTAT DHE PARIMET E TRAJTIMIT TË FËMIJËS VIKTIMË E ABUZIMIT

Neni 4

Trajtimi i fëmijës viktimë e abuzimit

1. Trajtimi mjekësor dhe psikologjik, i fëmijës viktimë e abuzimit, për t'i ndihmuar në rehabilitim dhe për t'u ri integruar në shoqëri, duhet të bazohet në parimet dhe të drejtat e përcaktuara në këtë Kapitull dhe nuk është e lejuar shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, Ligjin për mbrojtjen e fëmijës dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Procedura që ka të bëjë me trajtimin e rasteve të fëmijës viktimë e abuzimit, duhet të jetë:
 - 2.1 Emergjente dhe të përfundojë në afat të arsyeshëm;
 - 2.2 Efikase dhe me respekt të të drejtave të fëmijës si dhe
 - 2.3 në interesin më të mirë të fëmijës.

Neni 5

Interesi më i mirë i fëmijës viktimë e abuzimit

1. Të gjitha veprimet dhe vendimet, në të gjitha fazat, që kanë të bëjnë me rastet emergjente të fëmijës viktimë e abuzimit, të ndërmarra nga institucionet dhe nga profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, dhe që kanë të bëjnë me trajtimin mjekësor, psikologjik, dhe masat për rehabilitim dhe për ri integrim, duhet të jenë në interesin më të mirë të fëmijës dhe interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.
2. Interpretimi i interesit më të mirë, për fëmijën viktimë e abuzimit, duhet të jetë në tërësi në përputhje dhe me respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre të parapara me Kushtetutë, Konventë dhe Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës.
3. Asnjë interpretim i supozuar i asaj se çka është në interesin më të mirë të fëmijës nuk mund të justifikojë shkeljen e çfarëdo të drejte të njohur nga Kushtetuta, Konventa dhe Ligji për mbrojtjen e fëmijës.

Neni 6

Trajtimi i barabartë dhe me dinjitet i fëmijës viktimë e abuzimit

1. Gjatë trajtimit të fëmijës viktimë e abuzimit:

- 1.1. Fëmijët duhet të marrin të njëjtin trajtim mjekësor, psikologjik, dhe masa për rehabilitim dhe për ri integrim dhe nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, sipas kuptimit të cilido nga bazat e përcaktuara në dispozitat e Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi;
- 1.2. Asnjë fëmijë viktimë e abuzimit, nuk duhet të jetë subjekt i cenimeve të nderit dhe reputacionit të tij dhe duhet të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin, që zhvillon tek fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e fëmijës

Neni 7

E drejta e fëmijës viktimë të abuzimit për privatësi

1. Fëmijës viktimë të abuzimit, gjatë trajtimit mjekësor, psikologjik, dhe zbatimit të masave për rehabilitim dhe ri integrim, i garantohet e drejta për privatësi.
2. Të gjitha institucionet dhe të gjithë personat që merren me dhe rreth fëmijës viktimë e abuzimit, janë përgjegjës që të ndërmarrin masa për të mbrojtur privatësinë dhe identitetin e fëmijës, në pajtim me legjislacionin në fuqi, si dhe nuk duhet të publikohet asnjë informacion, që shpie në identifikimin e tij.
3. Të dhënat për trajtimin mjekësor, psikologjik, dhe masat për rehabilitim dhe ri integrim, për fëmijën viktimë e abuzimit, duhet të:

- 3.1. mbahen e të ruhen në një vend të sigurt;
- 3.2. mbahen konfidenciale;
- 3.3. jenë në dispozicion vetëm për personat e autorizuar dhe
- 3.4. përdoren vetëm për t'i ndihmuar në kujdesin shëndetësor.

4. Të gjitha institucionet dhe të gjithë personat duhet të jenë të rezervuar me mas mediale dhe mediale sociale e portalet e ndryshme, dhe duhet të marrin masa për të garantuar, që fëmija viktimë e abuzimit të mos jetë i identifikueshëm në asnjë rrethanë.

Neni 8

E drejta e fëmijës viktimë e abuzimit për t'u dëgjuar dhe informuar

1. Gjatë trajtimit mjekësor, psikologjik, dhe zbatimit të masave për rehabilitim dhe ri integrim, fëmija viktimë e abuzimit, për të gjitha çështjet dhe vendimet që kanë të bëjnë me te, ka të drejtën për t'i shprehur lirisht pikëpamjet e tij. Profesionistët që punojnë me fëmijën vlerësojnë pikëpamjet e fëmijës në përputhje me nivelin e pjekurisë, të kuptuarit e fëmijës dhe rrethanat e rastit.
2. Fëmija ka të drejtë të marrë informacion të mjaftueshëm dhe në kohë, në një gjuhë që e kupton, duke përfshirë edhe gjuhën e shënjave, në lidhje me trajtimin mjekësor, psikologjik, dhe masat për rehabilitim dhe masat për ri integrim.

Neni 9

E drejta e fëmijës viktimë e abuzimit për kujdes shëndetësor

1. Çdo fëmijë viktimë e abuzimit ka të drejtë në kujdesin shëndetësor adekuat, me qasje në vazhdimësi dhe pa diskriminim, në përputhje me parimet e kujdesit shëndetësor të përcaktuara në Ligjin për shëndetësi, me rregullat etike dhe profesionale, si dhe të udhëzohet apo referohet në shërbimin e caktuar shëndetësor, varësisht nga gjendja shëndetësore e fëmijës.
2. Ekzaminimi mjekësor i fëmijës viktimë e abuzimit:
 - 2.1 kryhen pa vonesa;
 - 2.2 kryhen nga profesionist shëndetësor, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre, në përputhje me rregullat e etikës dhe duke respektuar dinjitetin e fëmijës;
 - 2.3 shërbejnë për vlerësimin e gjendjes së përgjithshme mendore dhe fizike të fëmijës.

3. Në rast nevojë për ekzaminim mjekësor, askujt nuk i lejohet të zhveshë fëmijën apo të kërkojë që ai/ajo t'i tregojë pjesët e mbuluara të trupit, përveç profesionistëve shëndetësor, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre.
4. Pas përfundimit të ekzaminimit mjekësor përgatitet raporti mjekësor. Sipas nevojës dhe dhe rrethanave, ekzaminimi mjekësor mund të përsëritet.
5. Rezultatet e ekzaminimit mjekësor duhet të merren parasysh për ndërmarrjen e hapave të mëtuqjeshëm të trajtimit, rehabilitimit dhe ri integrimin të fëmijës.
6. Trajtimi i fëmijës viktimë e abuzimit, në institucione shëndetësore publike, është falas dhe është i liruar nga bashkë-pagesat.
7. Në rast se kujdesi shëndetësor, për fëmijën viktimë e abuzimit, nuk mund të sigurohet në institucione shëndetësore publike, fëmija ka të drejtë për kujdesin shëndetësor jashtë institucioneve shëndetësore publike, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 10

E drejta e fëmijës viktimë e abuzimit për rehabilitim dhe ri integrim

1. Fëmija viktimë e abuzimit ka të drejtë në asistencë të vazhdueshme për t'u rehabilituar dhe ri integruar në shoqëri.
2. Masa rehabilituese dhe ri integruese hartohen bazuar në nevojat specifike të fëmijës dhe duhet të kenë qëllim final ribashkimin me dinjtet me familjen, ri integrimin në komunitet dhe në jetën sociale.
3. Gjatë ofrimit të masave rehabilituese dhe ri integruese, fëmijës i ofrohet mbështetje dhe këshillim i vazhdueshëm për të shmangur ri viktimizimin dhe përjashtimin social.

KAPITULLI III - PËRGJEGJËSITË INDIVIDUALE DHE INSTITUCIONALE

Neni 11

Përgjegjësia për bashkërendim dhe bashkëpunim për mbrojtjen e fëmijës viktimë e abuzimit

1. Institucionet dhe profesionistët, gjatë trajtimit mjekësor dhe psikologjik, si dhe gjatë ndërmarrjes së masave për rehabilitim dhe ri integrim të fëmijës viktimë të abuzimit, kanë përgjegjësi të:
 - 1.1 marrin masat e domosdoshme që të sigurojnë bashkëpunimin dhe bashkërendimin sipas fushave që mbulojnë;
 - 1.2 veprojnë me shpejtësinë dhe efektivitetin e duhur;

1.3 pas kërkesës përkatëse, shkëmbejnë me njëri-tjetrin informacion në lidhje me gjendjen dhe nevojat e fëmijës;

1.4 angazhohen, që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm shëndetësor.

2. Secila palë do të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente shtetërore, të shoqërisë civile, të sektorit privat, në mënyrë që të zbatohen në mënyrën e duhur masat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 12 **Përgjegjësitë familjare**

1. Prindërit, kujdestarët dhe anëtarët e tjerë të familjes janë përgjegjës të përkujdesen për shëndetin e fëmijës dhe për të siguruar që fëmija viktimë e abuzimit, të merr trajtim mjekësor, psikologjik, si dhe masa për rehabilitim dhe ri integrim.
2. Institucionet dhe profesionistët që punojnë për mbrojtjen e fëmijës duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që kujdesi shëndetësor të zhvillohet në bashkëpunim dhe bashkëveprim me familjen.
3. Gjatë trajtimit mjekësor dhe psikologjik, si dhe gjatë ndërmarrjes së masave për rehabilitim dhe ri integrim, të fëmijës viktimë të abuzimit, Menaxheri i rastit duhet të punojë sipas parimit me familjen dhe partnerët për fëmijën, dhe duhet të zbatohet udhëzuesi përkatës për zbatimin e këtij parimi.
4. Vetëm në rrethanat kur ka arsye për të dyshuar se një fëmijë është duke pësuar dëm, ose është në rrezik për diçka të tillë brenda familjes së tij, mund të merret në konsideratë heqja e tij nga përkujdesja e prindit ose kujdestarit, dhe masat e kujdesit shëndetësor të bëhen jashtë familjes, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 13 **Përgjegjësitë institucionale**

1. Kur familja dështon të përkujdeset që të sigurojë trajtimin e duhur të fëmijës viktimë të abuzimit, dhe/apo kur fëmiju abuzohet nga prindërit, kujdestari dhe apo nga anëtarët e tjerë të familjes, QPS është përgjegjëse për të ndërmarrë masa për mbrojtjen e fëmijës, si dhe për të garantuar që masat e ndërmarra të:

1.1 fokusohen në mbrojtjen e fëmijës dhe sigurinë e tij;

1.2 fokusohen në të drejtat e fëmijës;

1.3 synojnë shmangien e riviktimizimit të fëmijës;

1.4 bazohen në një qasje të integruar, e cila merr parasysh marrëdhënien midis fëmijës dhe mjedisit të tij më të gjerë social;

1.5 lejojnë, sipas rastit, një gamë mbrojtjeje dhe shërbimesh shëndetësore mbështetëse;

1.6 trajtojnë nevojat specifike të fëmijës viktimë e abuzimit, dhe t'u vihen në dispozicion atyre.

Neni 14 **Përgjegjësitë e komunës**

Komuna brenda territorit të saj, është përgjegjëse për sigurimin e trajtimit mjekësor, psikologjik, dhe zbatimin e masave për rehabilitim dhe ri integrim, për fëmijën viktimë e abuzimit dhe/apo të bashkëpunojnë me komunat përkatëse për realizimin e këtyre masave, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 15 **Fondi për trajtimin e rasteve emergjente të fëmijës viktimë e abuzimit**

1. Drejtoria përkatëse për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në kuadër të komunës, në kuadër të Planit operativ të zhvillimit të kujdesit parësor shëndetësor, të cilin e miraton Ministria në propozim të Kuvendit të komunës, në pajtim me planin afat-mesëm të miratuar nga Qeveria, duhet të përfshijë edhe buxhet për një fond të veçantë për të trajtuar rastet emergjente të fëmijës viktimë e abuzimit.
2. Fondi i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni përdoret nga QPS-të, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 16 **Përgjegjësitë e Qendrave për Punë Sociale**

1. Përgjegjësitë e QPS në rastet e fëmijës viktimë e abuzimit përfshijnë:
 - 1.1 identifikimin e fëmijës së abuzuar apo në rrezik të abuzimit nëpërmjet informacioneve të siguruar nga vetë qendra përkatëse për punë sociale, marrjes së referimeve nga institucionet e tjera, organizata, anëtarët e komunitetit, publiku, familja, vetë fëmija dhe media;
 - 1.2 mbrojtjen e fëmijës viktimë e abuzimit, në cdo kohë sipas nevoje edhe jashtë orarit zyrtar të punës;
 - 1.3 sigurimin që fëmija viktimë e abuzimit, të merr trajtim mjekësor, psikologjik, si dhe masa për rehabilitim dhe ri integrim.
 - 1.4 kryerjen e detyrave dhe përgjegjësiave tjera që janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 17
Përgjegjësitë e shkollës

1. Përgjegjësitë e shkollës në rastet e fëmijës viktimë e abuzimit përfshijnë:
 - 1.1 identifikimin e rasteve të dyshimta të fëmijës viktimë e abuzimit dhe referimin në kohë pranë policisë dhe apo në QPS, në kompetencë territoriale të komunës dhe autoriteteve përgjegjëse për t'i ofruar ndihmën e nevojshme fëmijës;
 - 1.2 bashkëpunimin me institucionet përkatëse për zbatimin e trajtimit mjekësor, psikologjik, dhe masat për rehabilitim dhe ri integrim për fëmijën/nxënësin e shkollës përkatëse i cili është viktimë të abuzimit;
 - 1.3 pjesëmarrjen në tryezën për menaxhimin e rastit dhe mbështetjen për zhvillimin dhe zbatimin e planeve individuale të hartuara për fëmijën viktimë të abuzimit;
2. Mësimdhënësit dhe ekipet profesionale brenda shkollës duhet të ndihmojnë në hartimin dhe zbatimin e masave për rehabilitim dhe ri integrim të fëmijës, të gërshetuara edhe me trajtimin mjekësor dhe psikologjik (psikologu i shkollës etj.), dhe sipas nevojë duhet edhe të ofrojnë:
 - 2.1. lehtësimin dhe mbështetjen për ndjekjen e shkollës nga fëmijët të cilët janë identifikuar si viktimë të abuzimit;
 - 2.2. parandalimin dhe edukimin e fëmijës për të shmangur situatat e abuzimit;
 - 2.3. siguri që stafi pedagogjik apo personat e punësuar në institucionet arsimore të jenë persona të sigurt për të punuar me fëmijën.
3. Ministria përkatëse për arsim, ndermerrë hapat e nevojshëm për të përfshirë materiale mësimore mbi çështjet e parandalimit të abuzimit të fëmijës, të përshtatura me kapacitetin në zhvillim të nxënësve në programet mësimore zyrtare dhe në të gjitha nivelet arsimore.

Neni 18
Përgjegjësitë e policisë

1. Përgjegjësitë e policisë në rastet e fëmijës viktimë e abuzimit përfshijnë:
 - 1.1 identifikimin e rasteve kur dyshohet për abuzim të fëmijës dhe referim tek QPS;
 - 1.2 marrja e menjëhershme në mbrojtje e fëmijës viktimë të abuzimit në rrezik dhe referimin e tyre pranë QPS, edhe kur këto raste identifikohen jashtë orarit zyrtar të punës.
 - 1.3 plotësimi i kërkesës për lëshimin e urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes kur fëmijët janë në rrezik të lartë në bashkëpunim me QPS;

- 1.4 fillimin e hetimeve në rastet kur ka dyshim të bazuar dhe prova të mjaftueshme për veprë penale të kryer ndaj fëmijës, si dhe përpilimin e kallëzimit penal ndaj të dyshuarit/ve;
- 1.5 marrjen pjesë në tryezën për menaxhimin e rastit dhe mbështetjen për zhvillimin dhe zbatimin e planeve individuale të hartuara për fëmijën;
- 1.6 mbështetjen e menjëhershme të QPS kur është e nevojshme, gjatë vizitave në familje, gjatë identifikimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijës që është në rrezik të lartë;
- 1.7 mbështetjen dhe bashkëpunimin me QPS për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme informuese me qëllim parandalimin e abuzimit të fëmijës;

Neni 19

Neni 19

Neni 19

Përgjegjësitë e Qendrës kryesore të mjekësisë familjare

- 1. Përgjegjësitë e Qendrës kryesore të mjekësisë familjare dhe profesionistëve shëndetësor, në rastet e fëmijës viktimë e abuzimit, përfshijnë:
 - 1.1. identifikimin e fëmijës së abuzuar gjatë ofrimit të shërbimit shëndetësor dhe në bazë të vlerësimit referimi në nivelet tjera shëndetësore si dhe referimin e menjëhershëm të rastit pranë policisë dhe QPS-së;
 - 1.2. trajtimin me kohë dhe pa vonesa të rasteve emergjente të abuzimit të fëmijës, duke përfshirë ekzaminimet dhe analizat, në mënyrë që të rifitojë shëndetin fizik dhe mendor, të rehabilitohet nga trauma fizike dhe mendore që mund të ketë përjetuar;
 - 1.3. përpilimin e raporteve mjekësore mbi gjendjen shëndetësore të fëmijës së abuzuar apo të supozuar si në rrezik të abuzimit;
 - 1.4. pjesëmarrje në tryezën për menaxhimin e rastit, mbështetjen për zhvillimin dhe zbatimin e planeve individuale të hartuara për fëmijën;
 - 1.5. mbështetjen dhe bashkëpunimin me QPS për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme me qëllim parandalimin e abuzimit ndaj fëmijës si dhe për rehabilitimin nga trauma fizike dhe mendore që mund të ketë përjetuar fëmija duke përfshirë edhe masat për t'u ri integruar në shoqëri.

Neni 20

Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe sektorin privat

- 1. Institucionet përkatëse bashkëpunojnë me shoqërinë civile dhe sektorin privat në luftën kundër abuzimit të fëmijës dhe për mbrojtjen e fëmijës.
- 2. Institucionet përkatëse nxisin sektorin privat, mediat e shkruara dhe elektronike, rrjetet sociale, për të marrë pjesë në përpunimin dhe zbatimin e politikave dhe për të caktuar udhëzime dhe

standarde vetë rregullatore për parandalimin e abuzimit të fëmijës dhe rritjen e respektit për dinjitetin e tyre.

KAPITULLI IV- PROCEDURA PËR VEPRIM ME FËMIJËN VIKTIMË E ABUZIMIT

Neni 21

Procedura për veprim me fëmijën viktimë e abuzimit

1. Procedura për veprim me fëmijën viktimë e abuzimit duhet të mundësojë:
 - 1.1. avancimin e mirëqenies së fëmijës;
 - 1.2. sigurimin e të gjitha masave, veprimeve dhe aktiviteteve, që të jenë në interesin më të mirë të fëmijës;
 - 1.3. që nga kontakti i parë me institucione, fëmija viktimë e abuzimit, prindërit ose kujdestarët e tyre, të informohen me kohë dhe në mënyrë adekuate për të drejtat e tyre;
 - 1.4. që të gjitha kontaktet me fëmijën viktimë e abuzimit të bëhen në mjedis adekuat, që do t'i përmbush nevojat e posaçme të fëmijës dhe në gjuhën që e kupton dhe e flet fëmija, me qëllim që të ketë mundësi më të volitshme për bashkëpunim nga vetë fëmija;
 - 1.5. evitimin e kontakteve të panevojshme të fëmijës dhe përfaqësuesve të institucioneve;
 - 1.6. që intervistimi, ekzaminimi dhe trajtimi të zbatohet nga profesionistë të trajnuar me kualifikim adekuat, njohuri të posaçme dhe përvoja në sferën e së drejtë së fëmijës;
 - 1.7. realizmin e rrjedhës efikase të informacioneve ndërmjet institucioneve dhe shërbimeve të përfshira në procesin e mbrojtjes së fëmijës viktimë e abuzimit;
 - 1.8. t'i mbrojë fëmijët nga riviktimizimi;
 - 1.9. të vihen në pah masat e ndihmës dhe mbrojtjes, të cilat mund të shfrytëzohen në çdo fazë të procedurës, me qëllim të zvogëlimit ose eliminimit të efekteve të dëmshme të dhunës ose të veprës penale ndaj fëmijës viktimë e abuzimit

Neni 22

Trajtimi i rasteve të fëmijës viktimë e abuzimit nga QPS

1. Për fëmijët viktimë e abuzimit, pas pranimit të informimit ose vënies në dijeni rreth fëmijës së abuzuar, Organi i Kujdestarisë përgjegjës sipas kompetencës territoriale, ofron mbrojtje dhe trajtim adekuat dhe cakton Menaxherin e rastit, i cili duhet të jetë punonjës i QPS të komunës përkatëse ku ka vendbanimin apo vendndodhjen fëmija si dhe duhet të jetë i trajnuar posaçërisht për t'u marrë me fëmijën viktimë e abuzimit.

2. Organi i Kujdestarisë dhe Menaxheri i rastit ka për detyrë të përkujdeset dhe është i obliguar të veprojë çdoherë si prind i mirë ndaj fëmijës viktimë e abuzimit.
3. Menaxheri i rastit, në bashkëpunim dhe koordinim me prindin apo kujdestarin dhe familjen, kur një gjë e tillë është e mundur, siguron që nevojat specifike të fëmijës në lidhje me trajtimin mjekësor dhe psikologjik, të merren parasysh gjatë shqyrtimit të rastit të referuar. Kur prindi ose kujdestari janë abuzues së fëmijës së tyre, organi i kujdestarisë mund të caktojë kujdestar të përkohshëm për fëmijën viktimë e abuzimit.
4. Në rrethanat kur një fëmijë është viktimë e abuzimit dhe vlerësohet se është në nevojë për trajtim mjekësor dhe psikologjik, QPS cakton vizita të rregullta mjekësore dhe psikologjike, në mënyrë, që të krijohet siguria dhe mirëqenia e fëmijës dhe t'i sigurohet fëmijës çfarëdo shërbimi, që konsiderohet i arsyeshëm. QPS, duhet të ndërmarrin të gjitha masat e duhura për të nxitur shërimin fizik dhe psikologjik dhe rehabilitimin e fëmijës viktimë e abuzimit, në mënyrë që të rifitojë shëndetin fizik dhe mendor, të rehabilitohet nga trauma fizike dhe mendore që mund të ketë përjetuar si dhe për t'u ri integruar në shoqëri.
5. Masat rehabilituese dhe ri integruese duhet të jenë afatgjata dhe të përfshihen në Planin individual për fëmijën.
6. Menaxheri i Rastit është përgjegjës për mbarëvajtjen e gjithë procesit dhe çdo rast duhet të trajtohet me një qasje shumëdimensionale dhe jo të izoluar.

Neni 23

Akomodimi i fëmijës në një vend të sigurt

1. Ras pranimit të informimit ose vënies në dijeni rreth fëmijës që dyshohet që ka përjetuar abuzim, hapi më i rëndësishëm dhe shumë urgjent është akomodimi i fëmijës në një vend të sigurt, më pas ndërmerren veprimet e mëtuftjeshme.
2. Fëmija që dyshohet që ka përjetuar abuzim, në rrethana normale dërgohet në familje, QPS, në ndonjë ambient të veçantë në shkollë, Shtëpinë për Mbrojtjen e Fëmijës apo ndonjë ambient tjetër gjatë procesit të vërtetimit të moshës dhe zbulimit të rrethanave dhe marrjes së informatave relevante nga fëmija.
3. Dërgimi i fëmijës viktimë e abuzimit në një stacion policor, përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër të mundshme, ku në këto raste ambienti duhet të jetë miqësor dhe ndaras nga të rriturit.
4. Transporti i fëmijës viktimë e abuzimit deri në stacionin policor, duhet të bëhet në kushte të përshtatshme duke marrë parasysh moshën e fëmijës dhe nuk duhet të bëhet transportimi me të rritur, kjo vlen edhe për rastet e dërgimit të fëmijës në QPS.

Neni 24
Vërtetimi i moshës

1. Pas akomodimit të fëmijës në një vend të sigurt, hap tjetër i rëndësishëm dhe shumë urgjent është konstatimi i moshës së fëmijës viktimë e abuzimit, dhe konform moshës ndërmerren veprimet e mëtutjeshme.
2. Në rast të dyshimeve, përcaktimin e moshës e bën profesionisti shëndetësor.

Neni 25
Moslënia vetëm e fëmijës viktimë e abuzimit

Është e ndaluar që fëmija viktimë e abuzimit të lihet vetëm, përveç rastit kur fëmija e kërkon këtë gjë me vullnetin e vet dhe profesionisti i specializuar në fushën e mbrojtjes së fëmijës e konsiderohen si të përshtatshme.

Neni 26
Ndalimi i përballjes dhe kontaktit të fëmijës me abuzuesin

1. Fëmija viktimë e abuzimit gjithnjë duhet të ndahet nga abuzuesi, madje edhe nëse abuzuesi është po ashtu fëmijë.
2. Fëmija viktimë e abuzimit nuk duhet të lihet të përballet, të ketë kontakte me abuzuesin për aq kohë sa nuk është mjaftueshëm i përgatitur psikologjikisht për t'u përballur, deri sa psikologu konsideron që fëmija është i përgatitur për një gjë të tillë.

Neni 27
Pranimi, regjistrimi, lëvizja dhe transferimi

1. Menëherë pas dërgimit në stacion policor apo në QPS, për secilin fëmijë viktimë të abuzimit, duhet të merren parasysh statusi dhe nevojat e tyre të veçanta, në pajtim me moshën, personalitetin, gjininë dhe nivelin e cënueshmërisë, si dhe shëndeti mental dhe fizik dhe që, siguron mbrojtjen nga ndikimet e dëmshme dhe situatat e rrezikshme. Në këto raste duhet pasur kujdes mbrojtjen e integritetit fizik, mendor dhe moral si dhe mirëqenien e fëmijës.
2. Në çdo stacion policor fëmijët duhen të mbahen ndaras nga të rriturit, përderisa nuk janë të së njëjtës familje.
3. Njoftimi për pranim në stacion policor, duhet bërë pa vonesë për prindin apo kujdestarin, dhe për QPS-në.
4. Pas regjistrimit dhe marrjes së informatave relevante, në prani të prindit apo kujdestarit dhe zyrtarit të shërbimeve sociale, fëmiju dërgohet në Qendrën kryesore të mjekësisë familjare ku duhet të bëhet ekzaminimi i fëmijës nga mjeku dhe referimi sipas nevojës.

5. Fëmija gjatë gjithë kohës duhet të jetë nën përcjelljen e prindit apo kujdestarit dhe në mungesë të tyre, apo kur nuk është në interesin më të mirë të fëmijës, fëmija duhet të jetë nën përcjelljen e zyrtarit të shërbimeve sociale të QPS-së.

Neni 28

Trajtimi mjekësor dhe psikologjik i fëmijës viktimë e abuzimit

1. Fëmijës viktimë e abuzimit, duhet t'i sigurohet trajtimi mjekësor dhe psikologjik.
2. Çdo fëmijë viktimë e abuzimit dërgohet tek mjeku familjar në komunën ku jeton, brenda zonës së përfshirjes të përcaktuar nga komuna, në Qendrën kryesore të mjekësisë familjare. Në rastet që nuk është në interesin më të mirë të fëmijës, mjeku familjar apo është në interesin më të mirë të fëmijës, mjeku familjar mund të ndërrohet.
3. Sipas nevojave dhe rasteve, në trajtimin e fëmijës viktimë e abuzimit, profesionistët në kujdesin parësor shëndetësor bashkëpunojnë me profesionistët shëndetësor në nivelin dytësor dhe tretësor, në pajtim me Ligjin për shëndetësi si dhe me Standardet e organizimit dhe funksionimit të shërbimit të mjekësisë familjare.
4. Në rastin kur është i nevojshëm një trajtim i specializuar mjekësor, institucioni i kujdesit shëndetësor parësor është i obliguar që ta referojë fëmijën në një institucionin tjetër shëndetësor të specializuar.
5. Gjatë ekzaminimeve mjekësore dhe psikologjike të fëmijës viktimë e abuzimit, është e rëndësishme që të respektohet tërësia dhe vazhdimësia e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në të tre nivelet, si dhe zbatimi i koordinimit dhe komunikimit të ndërsjellë në mes të niveleve të kujdesit shëndetësor.
6. Rekomandimet pas trajtimit mjekësor dhe psikologjik duhet të përfshihen në Planin individual për fëmijën.

KAPITULLI VI- DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 29

Vetëdijesimi i publikut

1. Ministria përkujdeset që në vazhdimësi të bëjë promovimin lidhur me trajtimin mjekësor dhe psikologjik të fëmijës viktimë e abuzimit, sipas dispozitave përkatëse të këtij udhëzimi administrativ dhe legjislacionit përkatës në fuqi.
2. Fushata vetëdijësuese përgatitet nga njësi përkatëse e Ministrisë, në bashkëpunim me institucionet përkatëse të cilat janë përgjegjëse dhe kompetente për mbrojtjen e fëmijës.

Neni 30

Trajnimet profesionale

1. Ministria, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, siguron trajnime profesionale të vazhdueshme për profesionistët shëndetësor në mënyrë që të përvetësojnë njohuritë dhe aftësitë minimale të nevojshme në mënyrë që të përgjigjen ndaj të gjitha formave të abuzimit të fëmijës.

2. Ministria përkatëse për çështje sociale, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, duhet të sigurojë trajnime profesionale të vazhdueshme, për profesionistët, të cilët janë të përfshirë direkt në mbrojtjen e fëmijës në Qendrat për Punë Sociale, të cilat duhet t'u sigurojnë atyre njohuri të theksuar në hollësisht për teknikat për rehabilitimin dhe ri-integrimin e fëmijës viktimë e abuzimit.

3. Ministria përkatëse për arsim, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, duhet të sigurojë trajnime profesionale të vazhdueshme, për personelin arsimor, në mënyrë që të fitojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të specializuara për të punuar me fëmijët e abuzuar.

Neni 31

Përgjegjësia për zbatim

1. Të gjitha institucionet relevante të Republikës së Kosovës, në pajtim me përgjegjësitë e përcaktuara, obligohen të:

1.1. planifikojnë dhe ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ.

1.2. marrin masat e nevojshme për të siguruar strukturën, organizimin, pajisjet, trajnimin dhe numrin e mjaftueshëm të ekspertëve të specializuar që merren me masat për trajtim mjekësor, psikologjik, rehabilitim dhe ri-integrim të fëmijës viktimë të abuzimit, në rastet emergjente.

2. Ministria, është përgjegjëse për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e masave mjekësore, psikologjike, rehabilitim dhe masave për ri-integrim të fëmijës viktimë të abuzimit.

Neni 32

Nxjerrja e Procedurave Standarde Operative

Ministria, sipas nevojës, për zbatimin e këtij udhëzimi administrativ mund të nxjerrë procedurat standarde operative dhe apo udhëzuesit përkatës.

Neni 33
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

2 Qershor 2023